

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit G. H., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr./2015 të datës 17.03.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala, dhe të akuzuarit, me datë 18.10.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

**AKT GJYKIM**

**I akuzuari:**

G. H., nga i ati A., dhe nëna X. e lindur K., i lindur me datë 23.10.1979, në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga " ", nr. , ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 28.05.2015, në orë të pavërtetuar, në Prizren, në rrugën " ", nr. , merr, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkt me një përçues me vendosjen e një fidi në dysheme, duke anashkaluar njëisorin elektrik, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të nergjisë elektrike, me ç' rast të dëmtuarës KEDS – Divizioni i rrjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material në vlerë të energjisë së shpenzuar,

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52 al.5, 73, 74, 75, 76 dhe 320 të KP-ës, te akuzuarit ia shqipton:

**DENIM ME KUSHT**

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale, dhe

## DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 10 (dhjetë) ditë burg.

E dëmtuara: KEDS Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr. [redacted]/15 të datës 17.03.2016, kundër të akuzuarit G. H. [redacted], nga Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Beqë Shala, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3332/2015 të datës 17.03.2016, kundër të akuzuarit G. H. [redacted], nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimiti i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari G. H. [redacted], në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale e cila më vihet në barë, unë në ditën kritike kur kanë qenë zyrtarët e të dëmtuarës KEDS për ta kontrolluar njehsorin, atë ditë edhe kam kuptuar që në njehsorin tim nuk regjistrohet energjia e shfrytëzuar dhe në këtë mënyrë anashkalohet njehsori elektrik gjegjësisht energjia elektrike furnizohet në mënyrë direkt, këtë nuk e kam ditur, e as vet nuk e kam bërë, ekziston mundësia që gjatë luftës në vitet 1999, shtëpia ime ka qenë e uzurpuar, dhe në atë kohë të jetë kryer edhe vepra e cila më vihet në barë, por duke pasur parasysh që njehsori është në emrin tim, e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë. Të cekurat më lart, i propozoj gjykatës që ti merr si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, po ashtu edhe faktin që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, punëtor, dhe me të ardhurat e mia mundohem të siguroj ekzistencën e familjes, dhe tërë familja ime varet nga puna ime. Andaj të gjitha të cekurat, i propozoj gjykatës që ti merr si rrethanë lehtësuese e po ashtu edhe faktin që kjo është hera e parë që bie në konflikt me ligjin dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethanë konsideroj

dhe propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 28.05.2015, në orë të pavërtetuar, në Prizren, në rrugën "██████████", nr. ████████, i akuzuari merr, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkt me një përçues me vendosjen e një fidi në dysHEME, duke anashkaluar njëSORIN elektrik, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të nERGJISË elektrike, me ç' rast të dëmtuarës KEDS – Divizioni i rrjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material në vlerë të energjisë së shpenzuar,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti së ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform neni 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, moshë e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i tre fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.589/2016 me datë 18.10.2016**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**



**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi patur pajtësi kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.